



BiEPAG



Rikthimi: Përfundimi i procesit të unifikimit të BE-së

Ecuria e kohëve të fundit në lidhje me anëtarësimin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6) në Bashkimin Evropian duket se është rasti i një hapi para e dy hapa pas - ose nëse do të përdornim një metaforë nga sporti i futbollit, porta për të shënuar gol duket sikur largohet përherë. Mungesa e progresit konkret dhe njohjes së plotë të progresit të arritur ka filluar të ketë efekt jo vetëm tek elitat politike, por edhe te publiku në përgjithësi. Teksa në pragun e Evropës po trokasim lojtarë të tjerë globalë që kërkojnë të përfitojnë nga rajoni, BE-së i duhet një rrugë bindëse që këto 6 vende të anëtarësohen në këtë organizëm. Rrugë përpara nuk ka pse të jetë radikale: duhen disa rregullime dhe të menduar në mënyrë krijuese që mekanizmat ekzistues të mund të funksionojnë ende. Por kjo duhet bërë në kontekstin e trajtimit të këtyre vendeve si anëtare të ardhshme të BE-së. Kjo nënkupton që këto vende të përfshihen më shpesh në proceset që BE përdor për të vlerësuar shtetet anëtare aktuale si dhe të gjenden forma që rrjedha e financimeve të pasqyrojë idenë se të gjashta këto vende janë shtete të ardhshme anëtare. Rishikimi i idesë së "linearizimit" (kanalizimit) të fondeve drejt BP6 do të ishte një pikë e shkëlqyer nga ku mund të fillohet ashtu si edhe hartimi i një udhërrëfyesi të qartë partneriteti për anëtarësimin në BE, të përshtatur për secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Zoran Nechev, Srdjan Majstorović, Jovana Marović, Donika Emini,
Gjergji Vurmo, Nedim Hogić

Përbalja me realitetin

Në tre vitet e fundit Bashkimi Evropian (BE) ka treguar në mënyrë të përsëritur se i ka kushtuar vëmendje vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të ardhmes së tyre evropiane. Në nivel të menduar strategjikisht, nisja me Perspektivën e Besueshme të Zgjerimit të vitit 2018 që parashikon vitin 2025 si datë të synuar për anëtarësimin e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) ashtu edhe vazhdimi me një sërë dokumentesh të publikuara (ku disa madje janë miratuar edhe zyrtarisht) synojnë rritjen e integritetit të rajonit në Bashkimin Evropian. 15 vjet pas premtimeve në Konferencën e Selanikut, vetëm në vitin 2018 u mbajt në Sofje një Samit BE-Ballkani Perëndimor, i ndjekur nga Samiti i Zagrebit në 2020, duke e sjellë Ballkanin Perëndimor përsëri në rendin e ditës. Takimi i ardhshëm i planifikuar në Lubjanë në fund të vitit 2021 është një nga aktivitetet e tjera të shumta që po ndërmerren për të rritur rimëkëmbjen social-ekonomike dhe konvergjencën me BE-në. Por, duke marrë parasysh se ku ishin vendet e Ballkanit Perëndimor katër apo pesë vjet më parë dhe ku janë sot, realiteti është se nuk ka ndonjë përparim të dukshëm drejt integritetit të këtij rajoni në BE. Anëtarësimi i fundit i suksesshëm (ai i Kroacisë) u bë në vitin 2013 – pra, tetë vjet më parë.

Nëse do të gjykonim procesin vetëm nga arritjet e deritanishme dhe nga të gjitha aktivitetet, proceset dhe deklaratat e njohura, mund të krijohet fare lehtë ideja se planet për hapat e fundit drejt riintegritetit të rajonit në Evropë janë në rrugë e sipër.

Në fakt, panorama është krejt ndryshe. Ajo që po shohim gjithnjë e më shumë është se disa Shtete Anëtare të BE-së kërkojnë dhe gjejnë arsye pafund për të zbehur procesin dhe për të mohuar çdo shpërblim për progresin e arritur nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Shtete të tilla fshihen pas institucioneve të BE-së që, nga ana tjetër, detyrohen të vendosin procedura të reja e të ndërlikuara apo t'i fryjnë debateve që nuk janë aq të rëndësishme sa problematikat e vetë vendeve të (mos)bashkimit për të nisur negociatat e anëtarësimit. Mungesa e vullnetit politik të vërtetë dhe të sigurtë nga ana e disa shteteve anëtare të BE-së, do të thoshin disa, dhe mungesa e vizionit strategjik për të integruar Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin që tani shtrihet në kontinentin evropian, krijon pasiguri që ul besueshmërinë e BE-së dhe rrit rrezikun e zbehjes së dëshirës së vendeve të caktuara të Ballkanit Perëndimor për t'iu bashkuar BE-së. Me kalimin e kohës, kjo mund të krijojë një atmosferë në rajon ku jo vetëm vihen në dyshim elitat politike, por edhe qytetarë në përgjithësi mund të heqin dorë nga qëllimi i anëtarësimit.² Procesi aktual i anëtarësimit në BE nuk po prodhon rezultate pozitive dhe problemi është se, edhe me metodologjinë e re, nuk dihet nëse do të japë rezultate. Pasiguria e krijuar në këto vitet e fundit pasqyrohet më mirë në sondazhin e EFB/BiEPAG, ku evidentohet një qëndrim disi skeptik nga qytetarët e Ballkanit Perëndimor, kur u pyetën për kohëzgjatjen e procesit të anëtarësimit në BE (Tabela 1).




Tabela 1: Mendoni se anëtarësimi në BE do të ndodhë në 5/10/20 vjet apo kurrë?

- 1 Grupi Këshillimor i Politikave, Ballkani në Evropë, "Premtimi i papërbushur: Përfundimi i Zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit", (Balkans in Europe Policy Advisory Group, "Unfulfilled Promise: Completing the EU Enlargement to the Balkans,") 2014, <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/Unfulfilled-Promise-Completing-the-EU-Enlargement-to-the-Balkans.pdf>.
- 2 Matteo Bonomi, "Në kërkim të Autonomisë Strategjike të BE-së: Cili është roli i Ballkanit Perëndimor?" ("In Search of EU Strategic Autonomy: What Role for the Western Balkans?") (Istituto Affari Internazionali I.A.I., forthcoming).



Pasiguria shkakton frikë dhe dyshim për të ardhmen e rajonit brenda familjes evropiane. BE po humb përherë e më shumë terren në Ballkanin Perëndimor nga sa po e kupton dhe nuk është vetëm nga ndjenja e zhgënjimit që vjen nga procesi i zgjerimit të BE-së, por edhe nga një nocion racional i mungesës se theksuar të besimit mes qytetarëve të rajonit. Në një kohë kur Rusia po shtrin praninë e saj ushtarake në kufijtë e Evropës me Ukrainën dhe Krimenë e aneksuar në mënyrë të paligjshme dhe kur regjime të tjera autoritare po rrisin veprimtaritë dhe ndikimin e tyre dashakeqës në rajon (që synojnë të minojnë sistemet demokratike të këtyre vendeve), BE ka nevojë për një rajon të qëndrueshëm dhe të fortë në oborrin e saj të përparmë me qëllim që të garantojë sigurinë e saj. E vërteta është se BE po konkurren gjithnjë e më shumë për rritur ndikimin e saj pikërisht në oborrin e vet ku janë të pranishëm faktorë të tjerë të jashtëm, disa prej të cilëve me oreks tejet të madh për rajonin.

Sa më gjatë të presin vendet e rajonit para dyerve të BE-së, aq më delikate bëhen demokracitë dhe ekonomitë e tyre të reja. Konvergjenca e ngadaltë social-ekonomike, largimi i trurit dhe efektet e tjera të strategjive aktuale të stabilizimit gradualisht do të bëjnë që elektorati i vërtetë pro-evropian në Ballkanin Perëndimor të mos ketë më dëshirën të synojë konsolidimin e shtetit ligjor dhe të demokracisë, për shkak të mungesës së mbështetjes së rëndësishme nga BE për sa i përket legjitimitetit për t'i zbatuar këto politika në vend. Kur shohim edhe paketën financiare dukshëm më të ulët nga sa pritej për Ballkanin Perëndimor e që i ofrohet rajonit përmes Instrumentit të III në kuadër të Ndihmës së Para-Aderimit dhe Planit Ekonomik dhe të Investimeve, krahasuar me paketat që u jepen Shteteve Anëtare të BE-së përmes buxheti aktual afatgjatë të BE-së (Kuadri Financiar Shumëvjeçar) 2021-2027 dhe Fondit të Rimëkëmbjes të Brezit të Ri të BE-së, është gjithnjë e më e qartë se ekziston një rrezik serioz i divergjencës në rritje mes rajonit dhe BE-së. Rrjedhimisht, vendet e BP mund të kërkojnë fonde tek aktorë të tjerë të jashtëm.³

Dakordësimi për këto realitete është hapi i parë drejt hartimit të një qasjeje të re, të freskët dhe pragmatike ndaj rajonit. Është e nevojshme të mendohet në mënyrë strategjike dhe të rritet vëmendja ndaj rajonit, nëse BE synon që vendet kandidate të kontribuojnë në ringritjen e tyre pas viteve të pandemisë. Kështu mund të përgatitet rruga me progres të rëndësishëm në përmbushjen e qëllimit ambicioz të BE-së për autonomi strategjike. Shtetet anëtare

të BE-së duhet ta kuptojnë dhe të shprehin interesat e tyre të përbashkëta e ta konsiderojnë rajonin e BP si pjesë përbërëse të Bashkimit të ardhshëm Evropian, të veprojnë me më shumë vendosmëri për të arritur një qëndrim të përbashkët për sa i përket një këndvështrimi strategjik për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo do t'i tregonte botës se kapaciteti i saj për të vepruar është në rritje. BE nuk ka më luksin të vazhdojë me shtyrjen e vendimeve strategjike për t'i sinkronizuar ato me ciklet e ndryshme të zgjedhjeve politike të vendeve anëtare. Si mund të luajë rolin e tij Bashkimi "gjeopolitik" Evropian pa qenë i guximshëm, krijues dhe pa kapur çastin e ri vendimtar? Së bashku mund ta rinovojmë këtë ambicie pragmatike si një element të ri të së ardhmes së BE-së.

Përpjekjet që po japin fryte

Seti i instrumenteve aktuale të anëtarësimit në BE mund të jetë i mjaftueshëm. Instrumentet e nevojshme për mundësuar pranimin e këtyre vendeve që synojnë anëtarësimin janë në punë. Thjesht duhen përshtatje të vogla dhe rregullime të moderuara që të prodhojnë rezultatet e nevojshme. Për shembull, metodologjia e re për negociatat e anëtarësimit mund të konsiderohet si kuadër i ri politik për një proces teknik "të orientuar drejt anëtarësimit", që respekton plotësisht parimet e bazuara në meritë.⁴ Megjithatë, aktualisht po i kushtohet vëmendje më e madhe kushtëzimeve negative, si pezullimi i negociatave me një shtet në vend që të fokusohen tek shpërblimet; d.m.th., si mund të shpërblehen dhe t'u përshpejtohet integrimi në BE vendeve që po bëjnë detyrat mjaftueshmërisht mirë. Në thelb, pikërisht kjo ngre dyshimet për natyrën e vërtete të integritetit tek vendet që synojnë anëtarësim.

Kydokumentsynont'uvijënëndihmëvendimmarrësve të BE-së për të rikthyer frymën e anëtarësimit dhe potencialin transformues të procesit të zgjerimit me qëllim që t'i japë Komisionit Evropian mbështetjen e nevojshme politike për të vazhduar më tej me procesin. Çfarë sugjerojmë ne? Çfarë duhet për të arritur këtë imperativë të harruar që dikur ishte një nga politikat më të suksesshme të BE-së?

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë anëtarët e ardhshëm të BE-së. Duhet të trajtohen si të tillë, duke vlerësuar kështu nivelin e përafrimit dhe suksesit në zbatimin e ligjeve dhe rregullave të BE-së, në krahasim me shtetet aktuale anëtare. Askush nuk

3 Zoran Nechev et al., Metodologjia e re e anëtarësimit në BE. A mjafton për ta futur brenda Ballkanin Perëndimor? ("The New EU Accession Methodology. Is It Enough to Pull the Western Balkans In?") Institute for Democracy "Societas Civilis" - Shkup, 2021), https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/A5_WEB_New_Accession_Methodology_EU_WB-1.pdf.

4 Komisioni Evropian, "Tabela e Vlerësimit të BE-së për Drejtësinë," aksesuar më 12 qershor 2021, https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-law/eu-justice-scoreboard_en

duhet të ketë frikë se kjo qasje do të nxjerrë në pah situatën e mjerueshme në të cilën lëngon rajoni. Edhe sikur kështu të jetë gjendja, atëherë të gjithë do të sigurohen se këto vende (ose disa prej tyre) nuk janë ende gati për t'u anëtarësuar. Megjithatë, kjo shpalos potencialin e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u krahasuar, dalluar dhe konkurruar me më të mirët nga Unioni.

Të marrim, për shembull, Tabelën Vlerësuese të BE-së për Drejtësinë që publikon çdo vit Komisioni Evropian për të bërë një analizë krahasuese të efikasitetit, cilësisë dhe pavarësisë së sistemit të drejtësisë në të gjitha vendet anëtare të BE-së.⁵ Në vend të qasjes aktuale ku matet progresi i vendeve kandidate, do të ishte më efikase, ekonomike dhe racionale që Ballkani Perëndimor të integrohej në Tabelën Vlerësuese të BE-së për Drejtësinë dhe që vendet e rajonit të vlerësoheshin si anëtarë të një komuniteti më të gjerë e të përbashkët të shtetit ligjor dhe të krahasoheshin me shtetet anëtare të BE-së. Është më se e qartë se në këtë mënyrë do të kurseheshin më shumë kohë dhe energji nga Drejtoria e Përgjithshme e angazhuar me Ballkanin Perëndimor dhe vlerësimi do të bëhej bashkërisht me atë të shteteve anëtare.

Tabela Vlerësuese e BE-së për Drejtësinë dhe Shtetin Ligjor përdoret si referencë në procedurën e përgjithshme të Semestrit Evropian dhe i shërben të njëjtit qëllim në hartimin e Raportit të ri për Shtetin Ligjor. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e vendeve të Ballkanit Perëndimor në këtë Tabelë do të ofrojë informacione dhe të dhëna dhe do të bëjë gati rrugën për pjesëmarrjen në dy mekanizmat e tjerë të përmendur më sipër.

Semestri Evropian ofron kuadrin për bashkërendimin e politikave ekonomike mes vendeve të BE-së dhe shërben si platformë diskutimi për planet ekonomike dhe buxhetore të vendeve anëtare të BE-së. Me anë të tij monitorohet edhe progresi i arritur brenda afateve të caktuara. Sipas metodologjisë së re të zgjerimit, kriteret ekonomike janë pjesë e grupit ku janë edhe themelet më të rëndësishme. Kjo është bashkë me kapitujt e tjerë që lidhen me prokurimin publik, statistikën, kontrollin financiar, dhe shtetin ligjor dhe atë të funksionimit të institucioneve demokratike. Duke qenë se kjo është një risi në procesin e negociatave të pranimit (kriteret ekonomike), është ende për t'u diskutuar se si do t'i vlerësojë Komisioni këto kriteret ekonomike. Në vend që të bëjnë përpjekje të kota për të rishpikur rrotën, ajo që mund të bëjnë

institucionet është të integrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, për aq sa është e mundur, në kornizën e Semestrit Evropian. Duke vepruar në këtë mënyrë, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë rrezikun e çekuilibrave makroekonomikë dhe mund të ofrojë rekomandime strukturore specifike për vendet e Ballkanit Perëndimor siç do të bënte për çdo Shtet tjetër Anëtar të BE-së. Kjo mund të organizohet duke zëvendësuar Programet e Reformës Ekonomike që po përgatisin vendet kandidate me pjesëmarrjen e tyre të plotë në procedurat e bashkërendimit të politikës ekonomike të BE-së brenda Semestrit Evropian. Ky do të ishte një lloj plani embrional për konvergjencën ekonomike deri në anëtarësimin e plotë të këtyre vendeve.

Integrimi i Ballkanit Perëndimor në mekanizmat ekzistues të BE-së do t'u japë vendimmarrësve evropianë diçka konkrete mbi të cilën të bazojnë vendimet e tyre apo për të përshpejtuar ose për të ngadalësuar procesin e anëtarësimit duke u mbështetur në të dhëna krahasuese – jo vetëm nga vendet e Ballkanit Perëndimor por edhe nga shtetet anëtare të BE-së. Një gjë e tillë ndihmon të krijohet më shumë besim te procesi nga ana e shteteve aktuale anëtare.

Kur bie fjala për kapacitetin absorbues të BE-së si një kriter i veçantë për pranimin e Shteteve të reja Anëtare, është e rëndësishme të sigurohet që institucionet dhe qytetarët e BE-së të jenë të gatshëm, kur këto gjashtë vende të kenë përmbushur kriteret e nevojshme. Kjo do të ushqejë dimensionin institucional dhe qeverisës të kapacitetit absorbues (ndikim në aftësitë e BE-së për të vepruar) si dhe do të ketë ndikim pozitiv në dimensionin jashtëzakonisht të politizuar të pranimit që ka publiku i Shteteve ekzistuese Anëtare të BE-së⁵. Për ta nuk do të jetë surprizë, pasi do të mësohen t'i shohin dhe t'i konsiderojnë vendet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e Bashkimit të ardhshëm Evropian. Kjo është diçka që as fushata më e përgatitur e marrëdhënive me publikun së bashku me strategjinë më të mirë të komunikimit nuk do të mund ta bënte. Në vend që të shohin një vrimë në hartën e Evropës, ata do të shohin një Evropë të unifikuar dhe të integruar në aspektin territorial kur të drejtojnë vështirimin drejt juglindjes së kontinentit.

Kjo qasje do të ketë nevojë për rritjen e kapaciteteve të të gjitha drejtorive të përgjithshme duke rritur numrin e numrit e personelit, duke diversifikuar kështu portofolet me të cilat trajtohen aktualisht

5 Këshilli për Çështjet Ndërkombëtare, "Kapaciteti i BE-së për Zgjerim të Mëtejshëm" ("The EU's Capacity for Further Enlargement,") 2010, <https://www.advisorycouncilinternationalaffairs.nl/documents/publications/2010/07/02/the-eu-s-capacity-for-further-enlargement>.



vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit dhe Fqinjësisë do të ndërveprojnë rregullisht me vendet e Ballkanit Perëndimor një sërë institucionesh. Implikimi buxhetor për një lëvizje të tillë do të ishte i papërfillshëm krahasuar me efektin që do të kishte kjo qasje në procesin e integritetit, si nga ana e BE-së, ashtu edhe nga pikëpamja e SINJALIZIMIT. Sepse në fund, çështja nuk është vetëm tek kapacitetet e administratave të Ballkanit Perëndimor për t'u përafruar plotësisht me BE-në, por edhe tek kapacitetet e BE-së për të integruar vende të tjera në këtë rrugë të shtruar.

BP është pjesa më e pazhvilluar në aspektin socio-ekonomik në BE-në e ardhshme. Plani Ekonomik dhe i Investimeve i Komisionit për Ballkanit Perëndimor (PEI) është një përpjekje pozitive dhe tregues i gatishmërisë së BE-së për të ndihmuar në rimëkëmbjen ekonomike të vendeve në rajon dhe për të mbështetur tranzicionet e tyre të gjelbra dhe dixhitale. Megjithatë, është bërë e qartë se ekonomitë e dobëta në rajon do të kenë një rrugë mjaft të vështirë për të arritur konvergencën social-ekonomike pa një mbështetje më të madhe nga BE. Pikërisht dhjetë vjet më parë, vendet e Ballkanit Perëndimor i dërguan një kërkesë zyrtare KE-së për të rishikuar instrumentet e saj financiare të para-aderimit. Ato argumentuan se mbështetja financiare duhet të perceptohet si investim i përbashkët dhe se duhet të jepet që në fillim të procesit "për të transformuar ekonomitë dhe shoqëritë e tyre dhe për të modernizuar infrastrukturën e tyre" në përputhje me rregullat dhe standardet e BE-së. Kështu, ato mbrojtën idenë e "linearizimit" (kanalizimit), ose rritjes graduale të mbështetjes financiare në fusha me interes të përbashkët; të mbështetjes financiare për të vjelë përfitimet e para të zhvillimit ekonomik; dhe prezantimin e rregullave të ngjashme me ato që rregullojnë Fondet Strukturore të BE-së në mënyrë që të ndërtojnë kapacitetet absorbuese shumë më përpara se të anëtarësohen në BE, kohë gjatë së cilës këto vende do të kenë të drejtë të përfitojnë dhe të menaxhojnë shuma më të mëdha nga mbështetja financiare.

Aktualisht, parashikohet që vendet e Ballkanit Perëndimor të marrin "deri në" 9 miliardë euro përmes Planit të Investimeve Ekonomike për Ballkanin Perëndimor gjatë shtatë viteve të ardhshme. "Ka shumë mundësi të mobilizohet" një shtesë prej 20 miliardë euro me mbështetjen e Instrumentit të ri të Garancisë për Ballkanin Perëndimor. Në skenarin më të mirë, kjo do të shkonte në një shumë të ngjashme me atë që do të merrte një Shtet Anëtar i BE-së nga

rajonit përmes fondeve afatgjate buxhetore dhe instrumentit të rimëkëmbjes të NextGenerationEU (BreziiRiBE) gjatë së njëjtës periudhë. Për shembull, Kroacia, shtesa më e fundit në BE dhe fillimisht pjesë përbërëse e Ballkanit Perëndimor, do të marrë 22 miliardë euro përmes këtyre dy instrumenteve. Në shtatë vitet e ardhshme Shtetet Anëtare të BE-së nga ky rajon do të marrin deri në dhjetë herë më shumë mbështetje financiare për frymë sesa vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo do të thotë se hendeku ekonomik dhe social mes BE-së dhe BP6, pikërisht brenda këtij rajoni, më shumë do të zgjerohet sesa do të ngushtohet. Pasojat do të ishin shkatërrimtare për rajonin - duke mbetur më shumë prapa ekonomikisht, pa perspektivë të ardhshme për të rinjtë në rajon, do të çonte në shpopullim dhe rrjedhje të trurit, nëse do të përmendnim disa efekte.

BE duhet të rishqyrtojë kërkesën e bërë nga rajoni para dhjetë vjetësh dhe të mendojë për mënyra si të përmirësojë mbështetjen e saj për para-aderimin duke e bërë këtë mbështetje më efikase dhe të orientuar drejt zhvillimit. Kanalizimi i fondeve në fusha të tilla si mjedisi, energjia, infrastruktura e transportit, arsimi dhe shkenca ka potencial që të dy palët të dalin me fitim. Përafrimi i plotë i rregullave dhe rregulloreve IPA me modelin e Fondeve Strukturore të BE-së duhet të bëjë të mundur një përgatitje më të mirë administrative dhe institucionale për anëtarësimin efikas dhe efektiv të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Forcimi i mbështetjes financiare mund të luajë një rol më të madh në uljen e ndikimit dashakeqës të aktorëve të huaj në rajon dhe mund të krijojë mbështetje më të madhe e më efikase për prezantimin e politikave të kushtëzimit funksional në ato vende që shfaqin shenja të hapave prapa për sa i përket parimeve të shtetit ligjor dhe demokracisë.

Si të ecet përpara

Procesi aktual i aderimit në BE me vendet e Ballkanit Perëndimor nuk po prodhon rezultate që do t'i demokratizonin këto shoqëri dhe që do të rrisnin konvergencën social-ekonomike mes rajonit dhe BE-së. Instrumentet që nevojiten për të përmirësuar aderimin e këtyre vendeve që synojnë anëtarësimin janë në vend. Për të rikthyer fuqinë dhe natyrën transformuese të procesit, hapi i parë që duhet ndërmarrë është të arrihet konsensusi nga të gjitha palët e përfshira në lidhje me realitetet me të cilat përballen rajoni dhe të ndërveprohet me këto vende si anëtarë të ardhshëm të familjes evropiane.

Me t'u ndërmarrë ky hap, hapat e tjerë janë si më poshtë:

- Hartimi i një udhërrëfyese të qartë partneriteti për aderim të personalizuar për secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor;
- Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në mekanizmat aktualë të BE-së, si Tabela e Vlerësimit të BE-së për Drejtësinë, Raporti i ri i Shtetit Ligjor dhe korniza e Semestrit Evropian;
- Rritja e kapacitetit absorbues të BE-së duke diversifikuar portofolet me të cilat trajtohen vendet e Ballkanit Perëndimor në nivel evropian dhe të mos fokusohet vetëm në Drejtorinë e Zgjerimit dhe Fqinjësisë;
- Rritja e konsiderueshme e fondeve të kanalizuar për Ballkanin Perëndimor në mjedis, energji, infrastrukturë transporti ku qytetarët e këtyre vendeve të shohin përfitimet konkrete të aderimit në BE;
- Përafrimi i plotë i instrumentit për rregullat dhe procedurat e asistencës së para-aderimit me modelin e Fondeve Strukturore të BE-së.



Rreth nesh

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave.

Ky grup përbëhet nga hulumtues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Aktualisht, anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Vedran Džihic, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić, Jovana Marović, Srđan Majstorović, Richard Grieveson, Zoran Nechev, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nicolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergj Vurmo, Jelena Vasiljević, dhe Natasha Wunsch.

www.balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha kryesore - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE.

EFB mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platformën ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive, aleksandra.tomanic@balkanfund.org

www.suedosteuropa.uni-graz.at

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe edukimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar.

Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon konferenca dhe seminare ndërkombëtare rregullisht për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER, Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore, florian.bieber@uni-graz.at